

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Bazat e Auditimit të
Brendshëm**

B2

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

CONTENT / PËRMBAITJA

Pjesa	Maksimumi i Dhënë	<u>-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK- PIKËT E DHËNA</u>
1. Pyetje (50 x 2 pikë)	100	
Total	100	

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

1. Çfarë duhet të bëhet, kur auditorëve të brendshëm iu ndalohet me ligj ose me rregullore të përdorin pjesë të caktuara të standardeve IIA dhe / ose standardet e IIA janë përdorur së bashku me standardet e lëshuara nga organizata të tjera autoritative (dmth, standarde të tjera)?
 - I. Nëse ndalohet me ligj ose me rregullore, në raportin e auditimit shpalosni përputhshmërinë me të gjitha pjesët e tjera të Standardeve të IIA-së.
 - II. Nëse ndalohet me ligj ose me rregullore, në raportin e auditimit mos shpalosni përputhshmërinë me standardet e IIA-së.
 - III. Nëse standardet e IIA-së përdoren së bashku me standardet e tjera, dokumentoni përdorimin e standardeve të tjera në letrat e punës së auditimit.
 - IV. Nëse ekzistojnë mospërputhje ndërmjet standardeve të IIA-së dhe standardeve të tjera të përdorura së bashku, auditimi i brendshëm duhet të bëhet në përputhje me standardet e IIA-së dhe në përputhje me standardet e tjera vetëm nëse standardet tjera janë më kufizuese.
 - A. I dhe III.
 - B. II dhe III.
 - C. II dhe IV.
 - D. I dhe IV.
2. Cila nga të mëposhtmet lehtëson dhe zvogëlon koston e vlerësimit të jashtëm të një aktiviteti të auditimit të brendshëm?
 - A. Vlerësimi periodik i brendshëm i kryer brenda një kohe të shkurtër përpara vlerësimit të jashtëm.
 - B. Vlerësimi periodik i brendshëm i kryer paralelisht me vlerësimin e jashtëm.
 - C. Vlerësimi periodik i brendshëm i kryer brenda një kohe të gjatë para vlerësimit të jashtëm.
 - D. Vlerësimi periodik i brendshëm i kryer brenda një kohe të shkurtër pas vlerësimit të jashtëm.
3. Përforcimi i kodit të mirësjelljes dhe standardeve të sjelljes etike, për të gjithë auditorët e brendshëm, mund të mbrojë cilën nga të mëposhtmet?
 - A. Rrezikun e biznesit.
 - B. Dështimet e auditimit.
 - C. Sigurinë e rrejtshme të auditimit.
 - D. Rrezikun e reputacionit të auditimit.
4. Kur nëpunësit publik ose qytetarët kanë njohuri për veprime të paligjshme ose joetike, ligjet ose rregulloret përkatëse kërkojnë që ata të bëjnë cilën nga të mëposhtmet?
 - A. Merrni parasysh kallëzimin e brendshëm.
 - B. Merrni parasysh kallëzimin e jashtëm.
 - C. Informoni zyrtarët publikë ose Avokatin e Popullit.
 - D. Lëshoni një raport me qëllim të veçantë.
5. Në kompanitë publike, menaxhmenti shpesh kërkon përfshirjen e departamentit të auditimit të brendshëm në pasqyrat financiare tremujore që bëhen publike dhe / ose përdoren brenda kompanisë. Cila nga të mëposhtmet në përgjithësi nuk është arsye për një përfshirje të tillë?
 - A. Menaxhmenti mund të jetë i shqetësuar për reputacionin e tij në tregjet financiare.
 - B. Menaxhmenti mund të jetë i shqetësuar për ndëshkimet e mundshme që mund të ndodhin nëse pasqyrat financiare tremujore që bëhen publike përmbajnë anomali materiale.
 - C. Standardet theksojnë që auditorët e brendshëm duhet të përfshihen në shqyrtimin e pasqyrave tremujore financiare.
 - D. Menaxhmenti mund të perceptojë që informacioni financiar tremujor i shqyrtuar nga auditorët e brendshëm rrit vlerën e saj për vendimmarrjen e brendshme.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

6. Do të ishte e përshtatshme që departamentet e auditimit të brendshëm të përdorin konsulentët me ekspertizë në përfitimet nga kujdesi shëndetësor, kur departamenti i auditimit të brendshëm është:
- A. Duke kryer një auditim të vlerësimit të detyrimeve të organizatës për përfitimet e punonjësve pas pensionimit që përfshijnë përfitimet nga kujdesi shëndetësor.
 - B. Duke krahasuar kostot e programit të kujdesit shëndetësor të organizatës me programet e tjera të ofruara në industri.
 - C. Duke trajnuar stafin e tij për të kryer një auditim të shpenzimeve të kujdesit shëndetësor në një departament të madh të organizatës.
 - D. Të gjitha të mësipërmet.
7. Një auditor i brendshëm i raporton drejtpërdrejtë bordit të drejtorëve. Auditori zbuloi një mungesë materiale në paranë e gatshme. Kur u pyet personi përgjegjës, ai/ajo shpjegoi se paratë u përdorën për të mbuluar shpenzimet mjekësore në shuma të mëdha për një fëmijë dhe ra dakord të zëvendësoj fondet. Për shkak të veprimeve korigjuese, auditori i brendshëm nuk e ka njoftuar menaxhmentin. Në këtë rast, auditori:
- A. Ka pavarësi organizative, por jo objektivitet.
 - B. Ka pavarësi organizative dhe objektivitet.
 - C. Nuk ka pavarësi organizative, por ka objektivitet.
 - D. Nuk ka as pavarësi organizative, as objektivitet.
8. Standardet e Institutit Ndërkombëtar të Auditorëve të Brendshëm (IIA) përcaktojnë përgjegjësinë për ofrimin e mbikëqyrjes së duhur të punës së auditimit, tek:
- A. Komiteti i auditimit.
 - B. Drejtori i auditimit të brendshëm.
 - C. Mbikëqyrësi i auditimit.
 - D. Auditor i lartë.
9. Shefi ekzekutiv i auditimit (CAE) i një departamenti të ri të auditimit të brendshëm është duke kërkuar aprovimin e statutit. Cili është burimi autoritar për të kërkuar një miratim të tillë?
- A. Standardet e IIA-së, të cilat në mënyrë të qartë e vendosin atë përgjegjësi ndaj shefit ekzekutiv.
 - B. Këshillat e duhura praktike, të cilat kërkojnë nga shefi ekzekutiv që të marrë atë veprim.
 - C. Kodi i Etikës, i cili kërkon që auditorët e brendshëm të dokumentojnë politikën e kompanisë.
 - D. Sipas Standardeve të IIA-së, nuk është i nevojshëm aprovimi.
10. Një auditor gjen një rast ku ekziston dyshimi, por nuk ka dëshmi për gabime të mundshme. Standardi i Kujdesit të Duhur Profesional do të shkelej nëse auditori:
- A. Ka identifikuar mënyrat e mundshme sipas të cilave një gabim mund të ndodhë dhe ka renditur rastet për hetim.
 - B. E ka informuar menaxherin e auditimit të dyshimeve dhe ka kërkuar këshilla se si të vazhdohet më tutje.
 - C. Nuk ka kryer teste për gabime të mundshme sepse programi i auditimit ishte miratuar tashmë nga menaxhmenti i auditimit.
 - D. Zgjeron programin e auditimit, pa miratimin e të audituarit, për të trajtuar rastet në të cilat mund të ketë ndodhur gabimi.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

11. Ju është kërkuar që të jeni anëtar i një ekipi të rishikimit të kolegëve. Gjatë vlerësimit të pavarësisë së departamentit të auditimit të brendshëm që po rishikohet, ju duhet të konsideroni të gjithë faktorët e mëposhtëm, përveç:
- A. Qasjes dhe frekuencës së komunikimit me bordin e drejtorëve ose me komitetin e tij të auditimit.
 - B. Kriteve të arsimit dhe të përvojës të cilat konsiderohen të nevojshme kur mbushen pozitat e lira në stafin e auditimit.
 - C. Shkallës deri tek e cila auditorët marrin përsipër përgjegjësitë operative.
 - D. Qëllimit dhe intenzitetit të objektivave të auditimit për auditimet e përfshira në rishikim.
12. Standardet e IIA-së kërkojnë kryerjen e rishikimeve të brendshme periodike nga anëtarët e stafit të auditimit të brendshëm. Ky funksion është i dizajnuar që kryesisht t'i shërbejë nevojave të:
- A. Komitetit të auditimit.
 - B. Shefit ekzekutiv të auditimit.
 - C. Menaxhmentit.
 - D. Stafit të auditimit të brendshëm.
13. Sipas Standardeve të IIA-së, raportet e auditimit të brendshëm duhet t'u shpërndahen atyre anëtarëve të organizatës, të cilët janë në gjendje të sigurojnë se rezultatet e auditimit janë marrë parasysh. Për anëtarët e organizatës të nivelit më të lartë, kjo kërkesë zakonisht mund të plotësohet përmes:
- A. Raporteve të përkohshme.
 - B. Raporteve përmbledhëse.
 - C. Raporteve gojore.
 - D. Vetëm përmes raporteve të shkruara përfundimtare.
14. Sipas Standardeve të IIA-së, auditorët e brendshëm duhet të kenë të gjitha këto, përveç:
- A. Aftësisë në zbatimin e standardeve të auditimit të brendshëm.
 - B. Të kuptuarit të parimeve të menaxhimit.
 - C. Aftësisë për të ushtruar marrëdhënie të mira ndërpersonale.
 - D. Aftësisë për të kryer sesione trajnimi në metodat sasiore.
15. Cila nga të mëposhtmet më së miri përcakton një opinion të auditimit?
- A. Përmbledhja e gjetjeve të rëndësishme të auditimit.
 - B. Gjykimi profesional i auditorit për situatën e shqyrtuar.
 - C. Konkluzionet që duhet të përfshihen në raportin e auditimit.
 - D. Rekomandimet për veprime korigjuese.
16. Gjatë zbatimit të standardeve të sjelljes të përcaktuara në Kodin e Etikës, auditorët e brendshëm pritët të:
- A. Ushtrorjnë gjykimin e tyre individual.
 - B. Krahasojnë këto standarde me standardet në profesione të tjera.
 - C. Udhëhiqen nga dëshirat e të audituarit.
 - D. Përdorin lirinë për të vendosur nëse do t'i përdorin këto standarde, apo jo.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

17. Cila nga të mëposhtmet do të përbënte një shkelje të Kodit të Etikës të IIA-së?
- A. Lea ka pranuar një detyrë për të audituar departamentin e prodhimit të elektronikës. Ajo, kohët e fundit i është bashkuar departamentit të auditimit të brendshëm. Më parë, ajo ishte auditore e lartë gjatë auditimit të jashtëm të këtij departamenti dhe gjithashtu ka audituar shumë kompani të pajisjeve elektronike gjatë dy viteve të fundit.
 - B. Ledrit i është caktuar të bëjë një auditim të funksionit të magazinimit pas gjashtë muajsh. Ai nuk ka ekspertizë në këtë fushë por e ka pranuar angazhimin. Ledri është regjistruar në sesionet e edukimit të vazhdueshëm profesional në fushën e magazinimit, trajnim që do të përfundojë para se të fillojë angazhimi i tij.
 - C. Nina është e kënaqur me karrierën e saj si një auditore e brendshme dhe ka ardhur në fazën kur auditimin e brendshëm e sheh si një punë të rregullt prej 9 deri në 5. Gjatë tre viteve të fundit, ajo nuk ka ndjekur sesionet e edukimit të vazhdueshëm profesional ose aktivitete të tjera për të përmirësuar efektivitetin e saj. Megjithatë, ajo ndjen se po kryen të njëjtën punë cilësore që ajo gjithmonë e ka bërë.
 - D. Gjatë vitit, Joni ka zbuluar një mashtrim financiar të brendshëm. Librat e llogarive u rregulluan për të pasqyruar siç duhet humbjen e lidhur me mashtrimin. Joni e diskutoi mashtrimin me auditorin e jashtëm kur auditori i jashtëm shqyrtoi dokumentet e punës që detajonin incidentin.
18. Sipas Kodit të Etikës, Bordi i Drejtorëve i IIA-së mund të ndërmarrë veprime kundër një Auditori të Brendshëm të Çertifikuar, puna e të cilit është e pandershme duke:
- A. I kërkuar punëdhënësit të e shkakroj nga puna Auditorin e Brendshëm të Çertifikuar.
 - B. E raportuar aktin e pandershëm tek autoritetet ligjore.
 - C. I lëshuar një vërejtje punëdhënësit të Auditorit të Brendshëm të Çertifikuar.
 - D. Ia hequr thirrjen Auditor i Brendshëm i Çertifikuar.
19. Një rishikim i kodit të sjelljes së një organizate zbuloi se përmbante udhëzime gjithëpërfshirëse të dizajnuara për të frymëzuar nivele të larta të sjelljes etike. Shqyrtimi gjithashtu zbuloi se punonjësit ishin të informuar për dispozitat e saj. Megjithatë, disa punonjës ende nuk vepronin në përputhje me kodin. Cilin element duhet të përmbajë një kod i sjelljes për të rritur efektivitetin e tij?
- A. Rishikimin periodike dhe njohjen nga të gjithë punonjësit.
 - B. Përfshirjen e punonjësve në zhvillimin e tij.
 - C. Njohuri publike për përmbajtjen dhe qëllimin e tij.
 - D. Dispozitat për veprime disiplinore në rast të shkeljeve.
20. Një kompani telefonike ka marrë një mesazh anonim që tre auditorë të lartë të brendshëm janë në kundërshtim me Kodin e Etikës të IIA-së. Kompania ka miratuar Kodin e IIA-së si pjesë të kodit të saj etik të korporatës. Ankesat ndaj auditorit 3 ishin:
- Auditori 3.** Ka marrë pagë nga një botues për hartimin e një libri profesional për auditimin e brendshëm. Ka një punë me kohë të pjesshme si ndërmjetës i pasurisë së patundshme dhe firma e tij e pasurive të patundshme ka marrë një komision nga kompania punëdhënëse. Ka pranuar një artikull me vlerë nga një kolegë në kompanin ku është auditor, departamenti i të cilit kurrë nuk është audituar dhe nuk është në plan të auditohet në të ardhmen e afërt. Nuk ka përfshirë në raport të auditimit se bllokimet në një departament të transportit u shkaktuan nga mungesa e mbikëqyrësit. Mbikëqyrësja ishte mikja dhe fqinja e auditorit 3 e cila kishte një fëmijë të shtruar në spital, gjë që s'do të mund të kthehet në punë edhe për disa javë.

Sa nga ankesat ndaj Auditorit 3 paraqesin shkelje të Kodit të Etikës të IIA-së?

- A. Një.
- B. Dy.
- C. Tre.
- D. Katër.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

21. Për të qenë të suksesshëm, kompanitë e mëdha duhet të zhvillojnë mjete për të mbajtur organizatën të fokusuar në drejtimin e duhur. Sistemet e kontrollit të organizatës ndihmojnë që kompanitë të jenë të përqëndruara në drejtimin e duhur. Këto sisteme kontrolli përbëhen nga cila prej komponentëve të mëposhtme?
- A. Buxhetimi, analiza financiar dhe menaxhimi i parasë.
 - B. Objektivat, standardet dhe një sistem vlerësimi-shpërblimi.
 - C. Analiza e roleve, ndërtimi i ekipit dhe reagimet e pyetësorit.
 - D. Edukimi, mbrojtja dhe detyrat sfiduese.
22. Auditorët e brendshëm mund të vlerësojnë funksionin e menaxhimit të kontrollit duke përcaktuar nëse:
- A. Grupimi i aktiviteteve në një departament plotëson objektivat e departamentit.
 - B. Menaxhmenti është i pajisur me reagime të menjëhershme mbi variancat e performancës.
 - C. Normat e qarkullimit të punonjësve analizohen për trende dhe bëhen hetime për trende negative.
 - D. Problemet e parashikuara diskutohen, identifikohen dhe vlerësohen me zgjidhjet e mundshme të ofruara.
23. Një auditor i brendshëm po shqyrton përshtatshmërinë e politikave dhe procedurave ekzistuese në lidhje me aktivitetet e llogaritjes (kalkulimit) së përdoruesve të fundit. Auditori po teston:
- A. Një kontroll të aplikacionit.
 - B. Një kontroll organizativ.
 - C. Një kontroll mjedisor.
 - D. Një kontroll të sistemit.
24. Sipas raportit të Komitetit të Organizatave Sponsorizuese (COSO), cila prej të mëposhtmeve është komponenti më i rëndësishëm i kontrollit të brendshëm?
- A. Vlerësimi i rrezikut.
 - B. Mjedisi i kontrollit.
 - C. Aktivitetet e kontrollit.
 - D. Monitorimi.
25. Sipas raportit të Komitetit të Organizatave Sponsorizuese (COSO), thelbi i një organizate është cila nga të mëposhtmet?
- A. Produktet.
 - B. Proceset.
 - C. Njerëzit.
 - D. Fitimet.

26. Një punonjës i një kompanie sigurimi procesoi një kërkesë mashtruese për kredi për një shumë më të vogël se niveli i caktuar që kërkonte rishikim mbikëqyrës. Punonjësi pastaj ndërmori kontrollin dhe e arkivoi atë duke falsifikuar miratimin. Për të parandaluar paraqitjen e kredisë në një deklaratë të mëvonshme të siguruesit, shuma e kredisë u transferua në një llogari pezull. Cila nga të mëposhtmet do ta ekspozojë sa më parë këtë situatë?

- A. Raporti kompjuterik që identifikon hyrjet e pazakonta në llogarinë pezull.
- B. Përdorimi i kontrolleve të dosjeve të paranumëruara që trajtohen periodikisht.
- C. Auditimi i brendshëm vjetor.
- D. Harmonizimi i rregullt i llogarisë pezull i kryer nga një punonjës i pavarur.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

27. Sipas raportit të Komitetit të Organizatave Sponsorizuese (COSO), objektivat organizative bazohen në të gjitha të mëposhtmet, përveç:

- A. Preferencat.
- B. Fitimeve.
- C. Vlerësimet e vlerës.
- D. Stilit të menaxhimit.

28. Sipas raportit të Komitetit të Organizatave Sponsorizuese (COSO), një sistem efektiv i kontrollit të brendshëm kërkon një:

- A. Përdorues përfundimtar.
- B. Sponzor përfundimtar.
- C. Pronar përfundimtar.
- D. Klient përfundimtar.

29. Auditorët e brendshëm dhe menaxhmenti kanë shqetësime përherë e më të mëdha për sa i takon mashtrimeve kompjuterike. Cila nga procedurat e mëposhtme të kontrollit do të jetë më pak domethënëse për sa i takon parandalimit të mashtrimeve kompjuterike?

- A. Kontrolllet mbi ndryshimet e bëra në programe në të cilat kërkohet një dallim midis programeve që janë live dhe programeve që përdoren për teste.
- B. Testimi i aplikimeve të reja nga përdoruesit gjatë procesit të zhvillimit të sistemeve.
- C. Ndarja e detyrave midis programuesve të aplikimeve dhe funksionit të bibliotekarit të sistemit.
- D. Ndarja e detyrave midis programuesve dhe analistëve të sistemeve.

30. Të tre komponentët bazë të të gjitha sistemeve të kontrollit organizativ janë:

- A. Objektivat, standardet dhe një sistem vlerësimi-shpërblimi.
- B. Planet, buxhetet si dhe politikat dhe procedurat organizative.
- C. Raportet statistikore, auditimet dhe kontrollet financiare.
- D. Inputet, objektivat dhe një sistem vlerësimi.

31. Menaxhmenti zbuloi që një mbikëqyrës në njërin nga restorantet e tyre e merr fillimisht paranë gatshme dhe në fund të ditës e regjistron totalin e shitjeve gjatë gjithë ditës në sistemin e shitjes me pakicë-POS. Në mbyllje, mbikëqyrësi depoziton të holla të barabarta me shitjet e regjistruara në sistemin POS dhe mban pjesën tjetër. Mbikëqyrësi përcjell në departamentin e kontabilitetit të kompanisë raportet nga sistemi i shitjes me pakicë për mbylljen e ditës së bashku me një kopje të depozitës të parasë së gatshme. Departamenti i kontabilitetit regjistron shitjet dhe paranë e gatshme për restorantin në librin kryesor dhe verifikon depozitën me deklaratën bankare. Çdo ndryshim midis shitjeve dhe depozitave regjistrohet në një llogari të mbi / mungesave dhe nëse është e nevojshme, rishikohet me mbikëqyrësin e restorantit. Urdhërporositë ushqimore të konsumatorëve janë të paranimëruara dhe është përgjegjësi e mbikëqyrësit të shohë se ato janë numëruar në fund të çdo dite. Urdhërporositë e klientëve dhe transaksionet nga sistemi i shitjes me pakicë mbahen nga mbikëqyrësi për një javë dhe pastaj shkatërrohen. Cila nga procedurat e mëposhtme të auditimit do të kishte zbuluar mashtrimin?

- A. Përcaktimi i kontrolleve mbi verifikimin e depozitave të parasë së gatshme.
- B. Duke krahasuar një mostër të raporteve të shitjes me pakicë të mbylljes së ditës me kopjet e depozitave të parasë së gatshme.
- C. Në bazë të testimit, duke vërtetuar se urdhërporositë e ushqimit të konsumatorëve me numër serik janë paranimëruar.
- D. Për ditët e përzgjedhura, harmonizimi i urdhërporosive ushqimore të konsumatorëve me depozitat e parasë së gatshme ditore.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Mrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

32. Përvoja ka treguar se disa kushte në një organizatë janë simptoma të mashtrimit të mundshëm të menaxhmentit. Cila nga kushtet në vijim nuk do të konsiderohet tregues i mashtrimit të mundshëm?

- A. Menaxherët që rregullisht marrin detyrën e vartësve.
- B. Menaxherët që merren me çështje jashtë fushëveprimit të qendrës së fitimit të tyre.
- C. Menaxherët nuk janë në përputhje me direktivat dhe procedurat e korporatës.
- D. Menaxherët i nënshtrohen rishikimeve formale të performancës në baza të rregullta.

33. Roni dhe Gjoni kishin njohur njëri-tjetrin për shumë vite. Ata ishin bërë miq të mirë që në kolegji, ku të dy diplomuan në kontabilitet. Pas diplomimit, Roni mori në mbikëqyrje biznesin e familjes nga babai i tij. Familja e tij kishte një biznes ushqimor për disa breza. Kur Gjoni kishte vështirësi në gjetjen e një pune, Roni i ofroi atij punë në dyqanin e familjes. Gjoni dëshmoi të qenit një punonjës shumë i aftë. Ndërsa Gjoni demonstroi aftësitë e tij, Roni filloi të delegonte gjithnjë e më shumë përgjegjësi ndaj tij. Pas një periudhe kohore, Gjoni po kryente të gjitha autorizimet dhe funksionet e përgjithshme të kontabilitetit për çeqet, paratë, stoqet, dokumentet, regjistrimet dhe harmonizimet e deklaratave bankare.

(I) Gjoni u konsiderua plotësisht i besueshëm dhe i menaxhonte të gjitha funksionet financiare. Askush nuk e kontrollonte punën e tij. Roni vendosi të zgjerojë biznesin dhe hapi disa dyqane të reja.

(II) Roni trajtonte gjithmonë problemet më urgjente ... profesorët e tij të kolegjit e kishin quajtur "menaxher i krizës". Gjoni e ndihmonte me problemet kur punët e tjera të tij i lejonin kohë. Ndonëse ishte i suksesshëm në punë, Gjoni kishte vështirësi me problemet financiare personale.

(III) Në fillim, shumat që Gjoni vodhi ishin të vogla. Ai as nuk u shqetësua për të bërë bilancin e llogarive. Por Gjoni u bë lakmitar. "Sa e lehtë është të marrësh para," tha ai. Ai ndjeu se ai ishte një anëtar kritik i ekipit të biznesit, dhe se ai kontribuoi shumë më shumë në suksesin e kompanisë sesa ishte përfaqësuar nga paga e tij.

(IV) Do të duheshin dy ose tre vetë për të më zëvendësuar, ai shpesh mendonte për vetveten. Ndërsa shumat bëheshin çdo herë e më të mëdha, ai bëri bilancin e llogarive.

(V) Për shkak të këtyre aktiviteteve, Gjoni ishte në gjendje të blente një makinë të shtrenjtë dhe të merrte familjen e tij në disa udhëtime çdo vit.

(VI) Ai gjithashtu u bashkua me një klub të shtrenjtë të vendit. Gjithsesi, gjërat ndryshonin në shtëpi. Familja e Gjoni vuri re se shpesh ai ishte argumentues dhe në raste të tjera shumë në depresion.

(VII) Mashtrimi vazhdoi për gjashtë vjet. Çdo vit biznesi performoi gjithnjë e më keq. Në vitin e kaluar dyqanet humbën mbi 200,000€. Banka e Ronit kërkoi një auditim. Gjoni u rrëfye kur mendoi se auditorët kishin zbuluar përvetësimet e tij.

Kur diskutohen mashtrimet, shpesh janë identifikuar presionet, mundësitë dhe racionalizimet që shkaktojnë/lejojnë një keqbërës që të kryejë mashtrimin. Gjithashtu janë studiuar simptomat e mashtrimit.

Identifikoni faktorët e numëruar dhe të nënvizuar (nga skenari) si një nga simptomat, presionet, mundësitë ose racionalizimet e dhëna. **Numri II, "Roni trajtonte gjithmonë problemet më urgjente..."**, është një shembull i një:

- A. Mundësie për të kryer.
- B. Simptome analitike.
- C. Presioni të situatës.
- D. Racionalizimi.

**Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

Nga 2 pikë secila

34. Një auditor po heton performancën e një departamenti me një rritje të pazakontë të shitjeve, marzhës bruto dhe fitimit. Cili nga treguesit e mëposhtëm ka më së paku të ngjarë të tregojë mundësinë e mashtrimit të lidhur me shitjet në departament?

- A. Një pjesë e konsiderueshme e kompensimit të menaxhmentit të departamentit bazohet në fitimet e raportuara të departamentit.
- B. Një numër jashtëzakonisht i madh i kthimeve të shitjeve janë regjistruar pas fundit të vitit.
- C. Auditori ka marrë një mostër të rastësishme të faturave të shitjeve por nuk mund të gjejë një dokument të transportit për disa transaksione të shitjes të përzgjedhura për nëntor dhe dhjetor.
- D. Njëri nga konkurrentët kryesorë të kompanisë doli jashtë biznesit gjatë vitit.

35. Një ekip auditimi është caktuar për të rishikuar sistemin e matjes së kënaqësisë së klientit në departamentin e produkteve industriale të implementuar dy vjet më parë. Zyrja e shërbimit ndaj klientit e departamentit kryen një anketim vjetor përmes postës elektronike. Një anketë i dërgohet 100 blerësve të përzgjedhur në mënyrë të rastësishme nga të gjithë konsumatorët që kanë bërë blerje në 12 muajt e fundit. Anketa është tre faqe e gjatë dhe 30 pyetjet e saj përdorin një përzierje të mënyrave të përgjigjes (p.sh. disa pyetje janë të hapura, disa me zgjedhje të shumëfishta dhe të tjerat përdorin një shkallë përgjigjesh). Zyrja e shërbimit ndaj klientit e dërgon anketën në shtator dhe paraqet rezultatet e pyetësorëve të kthyer më 15 tetor. Vetëm një herë dërgohet anketa. Nëse konsumatori nuk e kthen pyetësorin, nuk shiqohet përse nuk është përgjigjur. Në anketimin e fundit, 45 pyetësorë nuk u plotësuan.

Pyetësorët përbëhen nga një sërë pyetjesh të ndryshme që përdorin të njëjtat kategori përgjigjesh (p.sh., fuqishëm pajtohem, pajtohem, indiferent, nuk pajtohem). Disa pyetësorë do të kenë grupe të ndryshme të verzioneve të alternativave të pyetjeve ndaj të anketuarve, ku pyetjet prezantohen me renditje të ndryshme dhe rirenditje të shkallëve të përgjigjeve (p.sh. pajtohem për pjesën e djathtë dhe nuk pajtohem për pjesën e majt, ose anasjelltas). Qëllimi i ndryshimeve të pyetësorit është:

- A. Për të eliminuar keqinterpretimet e qëllimshme.
- B. Për të ulur tendencën e përgjigjeve shabllon.
- C. Për të testuar nëse të anketuarit po e lexojnë pyetësorin.
- D. Për të bërë të mundur që të marrin informacione lidhur me një parametër të popullatës duke përdorur të njëjtat pyetje.

36. Menaxhmenti u përgjigj me "po" për çdo pyetje në një pyetësor të kontrollit të brendshëm dhe deklaroi se të gjitha kërkesat e listuara dhe aktivitetet e kontrollit ishin pjesë e procedurave të tyre. Një auditor i brendshëm e mori këtë pyetësor nga menaxhmenti gjatë vizitës së kontrollit të ndërmjetëm, por nuk i shqyrtoi përgjigjet me menaxhmentin.

Mbikëqyrësi i auditorit është duke bërë vlerësimin e performancës për auditorin për këtë kontroll të ndërmjetëm. Mbikëqyrësi thekson nevojën e shqyrtimit të përgjigjeve të pyetësorit me menaxhmentin gjatë kontrollit. Auditori duhet të ketë intervistuar menaxhmentin për informata shtesë, sepse teknika e intervistimit:

- A. Ofron mundësinë për të parashtruar pyetje për të hetuar fushat premtuese.
- B. Është mënyra më efikase për të përmirësuar informacionin në nivelin e dëshmimeve objektive.
- C. Është teknika më pak e kushtueshme e auditimit kur përfshihet një sasi e madhe informacioni.
- D. Është procedura e vetme e auditimit që nuk kërkon konfirmim dhe kalim përmes informacionit që është marrë.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

37. Një dallim i rëndësishëm midis një mostre statistikore dhe një mostre në bazë të gjykimit, është se me një mostër statistikore:

- A. Asnjë gjykim nuk kërkohet, gjithçka është sipas formulës.
- B. Mund të përdoren madhësi më të vogëla të mostrës.
- C. Mirren rezultate më të sakta.
- D. Vlerësimet e popullatës mund të bëhen me një besueshmëri të matshme.

38. Auditori vë në dukje një korrelacion të dobët të papritur midis normave të ulëta të interesit dhe hipotekave të mëdha të mbyllura dhe kërkon një shpjegim për refuzimin e shumicës së hipotekave të mëdha. Auditori duhet:

- A. Të marr një mostër në bazë të gjykimit drejtuar ndaj aplikacioneve për hipoteka të mëdha.
- B. Të marr një mostër të rastësishme të të gjitha hipotekave të mbyllura.
- C. Të zhvilloj një model regresioni për të shpjeguar marrëdhëniet.
- D. Të përdor programimin linear për të analizuar shpërndarjen e fondeve.

39. Përzgjedhja sistematike mund të pritët të prodhojë një përfaqësues kur:

- A. Tabelat e numrave të rastësishëm përdoren për të përcaktuar artikujt e përfshirë në mostër.
- B. Popullata është rregulluar në mënyrë të rastësishme në lidhje me objektivin e auditimit.
- C. Mostra është përcaktuar duke përdorur fillimin e shumëfishtë të rastësishëm dhe përfshin më shumë artikuj se sa që kërkohet.
- D. Mostrimi në bazë të gjykimit përdoret nga auditori për të kompensuar çdo paragjykim të mostrave.

40. Një auditor ka dizajnuar një mostër të veçorive për të testuar efektivitetin e një procedure kontrolli. Auditori ka dizajnuar mostrën për të arritur një kufi të sipërm të saktësisë prej 4% në një nivel të besueshmërisë prej 95% me një normë gabimi të pritët prej 1%. Bazuar në këta faktorë, auditori ka zgjedhur 156 artikuj dhe ka gjetur tre gabime. Auditori mund të konkludojë se ka:

- A. Të paktën 95% gjasa që norma e gabimit në popullatë e kalon 4%.
- B. Të paktën 95% gjasa që norma e gabimit në popullatë është më pak se 4%.
- C. Më pak se 95% gjasa që norma e gabimit në popullatë është më pak se 4%.
- D. Më shumë se 95% gjasa që norma e gabimit në popullatë e kalon 1%.

41. Në një aplikacionit të mostrimit të ndryshoreve, nëse shkalla e saktë e dollarit të arritur të mostrës statistikore në një nivel të caktuar të besueshmërisë është më e madhe se sasia e dëshiruar e dollarit, kjo është një tregues se:

- A. Norma e ndodhjes ishte më e vogël se sa pritej.
- B. Norma e ndodhjes ishte më e madhe se sa pritej.
- C. Devijimi standard ishte më i vogël se sa pritej.
- D. Devijimi standard ishte më i madh se sa pritej.

42. Auditori i brendshëm për një kompani sigurimi po kryen një auditim të kërkesave për rimbursim dhe dëshiron të vlerësojë gjatësinë e kohës mesatare për të procesuar kërkesat e rimbursimit të automobilave për të përcaktuar nëse procesimi po përfundohet brenda standardeve të përcaktuara në politikën e kompanisë. Auditori po planifikon të marrë një mostër të kërkesave të bëra gjatë vitit dhe të kryejë analizën e nevojshme. Metoda më e përshtatshme e marrjes së mostrave do të ishte:

- A. Marrja e mostrave mesatare për njësi.
- B. Probabiliteti proporcional me madhësinë.
- C. Mostrimi i veçorive.
- D. Marrja e mostrave të zbulimit.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

43. Një plan i mostrimit është i nevojshëm për të testuar mbivlerësimin prej 3 milion euro të librit të llogarive të pagueshme. Auditori konstaton se një gabim prej 100,000€ është material dhe një nivel i besueshmërisë prej 95% është i përshtatshëm. Bazuar në këto përcaktime, nevojitet mostër e madhësisë prej 90. Plani i marrjes së mostrave që ka të ngjarë të përdoret është:

- A. Ndal dhe shko.
- B. Marrjen e mostrave të grumbullimit.
- C. Mostrat e njësisë së euros.
- D. Mostrimi i veçorive.

44. Gjatë kryerjes së procedurave analitike lidhur me një auditim të një agjencie të shërbimeve sociale të një subjekti qeveritar, auditori vuri në dukje se kishte një rritje jashtëzakonisht të madhe të pagesave për përfituesit individualë që janë nën drejtimin e një punonjësi të caktuar social në agjenci. Auditori po shqyrton opsionin e dhënies së një rekomandimi për kontrollet e duhura për të adresuar një problem potencial të marrësve fiktivë. Auditori ka identifikuar procedurat e mëposhtme të kontrollit si pikat potenciale për tu përfshirë në rekomandim.

- I. Kërkoni që të gjitha shtesat në dosjen e marrësit të hetohen dhe miratohen në mënyrë të pavarur nga një mbikëqyrës i punonjësve socialë.
- II. Kërkoni përdorimin e shifrave të vetidentifikimit për punonjësit socialë në numrat e llogarive të të gjithë marrësve, në mënyrë që çdo dublikat të vihet në dukje menjëherë nga sistemi.
- III. Përfshini një kod në programin kompjuterik për të kërkuar emrat dhe adresat e dublikuara. Zhvilloni një raport përjashtimi që do t'i shkojë mbikëqyrësit sa herë që të identifikohen dublikimet.
- IV. Kërkoni rotacionin e mbikëqyrësit të punëtorëve socialë.

Cila nga kombinimet e mëposhtme të kontrollit do të adresonte në mënyrë efektive shqetësimet e auditorit dhe do të përmirësonte kontrollin mbi përfituesit e vlefshëm?

- A. I, II, III dhe IV.
- B. I, II dhe III.
- C. I dhe IV.
- D. I, III dhe IV.

45. Një auditor i brendshëm dyshon se faturat nga një numër i vogël i furnitorëve përmbajnë gabime serioze dhe për këtë arsye kufizon mostrën vetëm për ata furnitorë. Disavantazhi kryesor i zgjedhjes së një mostre të tillë të artikujve për t'u shqyrtuar është:

- A. Vështirësia e sigurimit të artikujve të mostrës.
- B. Pamundësia për të kuantifikuar gabimin e mostrimit në lidhje me popullatën e përgjithshme të faturave nga furnitorët.
- C. Mungesa e një shpërndarje normale.
- D. Tendenca për të mostruar një numër më të madh të njësive.

46. Cila metodë e vlerësimit të kontrollit të brendshëm gjatë rishikimit paraprak i ofron auditorit sqarimin më të mirë vizual të një sistemi ndërsa shërben si një mjet për analizimin e operacioneve më komplekse?

- A. Një qasje e skemave të rrjedhjes së punës.
- B. Një qasje e pyetësorëve.
- C. Një qasje matricë.
- D. Një qasje e detajuar treguese (narrative).

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

47. Auditori i brendshëm përdor një numër teknikash për të zgjedhur mostrat. Një teknikë e përdorur shpesh dhe e përshtatshme, është përzgjedhja e rastësishme. Në cilën nga situatat e mëposhtme do të ishte përzgjedhja e rastësishme më pak e justifikuar? Auditorit i duhet të:
- A. Testoj transaksionet e shitjes për të përcaktuar se ato ishin të autorizuar siç duhet dhe mbështeten nga dokumentet e transportit.
 - B. Konfirmoj llogaritë e arkëtueshme dhe tashmë ka zgjedhur 10 llogaritë më të mëdha për konfirmim. Llogaritë e mbetura nuk numërohen. Auditori ka vetëm një listë kompjuterike të llogarive në mënyrë alfabetike të gjatë rreth 250 faqe me 50 saldo të llogarive në çdo faqe.
 - C. Siguroj prova për ndërprerjen (cutoff) e duhur të shitjes duke marrë mostra nga ditarët e shitjeve mujore për të përcaktuar nëse artikujt janë regjistruar në periudhën e duhur kohore.
 - D. Testoj regjistrimet e stoqeve të përhershme për të siguruar që mostra mbulon vlerat më të mëdha të aritkujve në euro në llogari.
48. Cila nga të mëposhtmet është një shembull i dëshmimeve në formën e dokumenteve?
- A. Një fotografi e vendit të punës të të audituarit.
 - B. Një letër nga një ish-punonjës pretendon një mashtrim.
 - C. Një faqe e librit të kryesor që përmban parregullsitë e vendosura aty nga kryerësi i një mashtrimi.
 - D. Një faqe e dokumenteve të punës të auditorit që përmbajnë llogaritjet që tregojnë ekzistencën e një gabimi ose parregullsie.
49. Cila nga procedurat e mëposhtme do të siguronte dëshminë më të mirë të efektivitetit të një funksioni të dhënies së kredisë?
- A. Vëzhgimi i procesit.
 - B. Shqyrtimi i trendit të shlyerjes së të arkëtueshmeve.
 - C. Bërja e pyetjes ndaj menaxherit të kredisë për efektivitetin e funksionit.
 - D. Kontrollimi i dëshmisë së miratimit të kredisë në një mostër të porosive të klientëve.
50. Cila nga procedurat e mëposhtme të auditimit do të ishte më efektive në përcaktimin nëse faturat e furnitorit po procesohen në kohën e duhur, duke maksimizuar përdorimin e parave të gatshme nga kompania?
- A. Përcaktoni kohëzgjatjen e kohës së procesimit ndërmjet marrjes së faturës së furnitorit dhe datës së pagesës përkatëse.
 - B. Intervistoni menaxherin e llogarive të pagueshme për të përcaktuar procedurat dhe standardet për procesimin e faturave të furnitorëve.
 - C. Krahasoni datën për pagesë në faturën e furnitorit me datën e pagesës siç tregohet në çeqe.
 - D. Krahasoni datën e vulosur në faturë për marrjen e faturës me datën përkatëse të pagesës.